



ГРАД СКОПЈЕ - QYTETI I SHKUPIT

QYTETI I SHKUPIT
SEKTORI PËR ZHVILLIM LOKAL EKONOMIK
SHKUP

Бр. Nr. 08-6126 / 3
18. 05. 2026
20
СКОПЈЕ - SHKUP

**BASHKËNGJTIJE E APLIKIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE
FINANCIARE PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT
“Organizimi i shikimit turistik të Shkupit”**

**PËRMBAJTJA, KUSHTET DHE KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOHEN
NGA ANA E REALIZUESIT TË PROJEKTIT
“Organizimi i shikimit turistik të Shkupit”**

1. PËRMBAJTJA E PROJEKTIT

- Projekti parashikohet të sigurojë organizimin e shikimit turistik falas të qytetit të Shkupit për të gjithë të interesuarit, në bashkëpunim me asociacionet dhe/ose shoqatat e guidave turistike dhe shoqëruesve me seli në Shkup, me qëllim zhvillimin e turizmit dhe krijimin e një oferte më të mirë turistike në qytet.
- Të ofrojë listë të guidave turistike të licencuar - pjesëmarrës në aktivitet;
- Të ketë pjesëmarrjen e guidave të licencuar turistike nga Qyteti i Shkupit të cilët do të kryejnë mbikëqyrjen mbi organizimin e tureve turistike;
- Me këtë projekt, pritet realizuesi të organizojë 25-30 ture falas për përdoruesit me agjendë të propozuar më parë për takime gjatë javës së punës dhe fundjavave nga 01.06- 31.12. 2026;
- Të ofrojë agjendë për tur të organizuar që zgjat 2-3 orë në ditë në vende të ndryshme kulturore dhe historike, objekte dhe atraksione nga trashëgimia kulturore në zonën qendrore të Shkupit, por edhe të përfshijë ditë në muaj ku do të ofrohet tur me autobus në Kanionin Matka, me interval kohor prej 2 deri në 3 orësh.

2. KUSHTE PËR REALIZIMIN E AKTIVITETIT

- Pesë vite eksperiencë në organizimin e tureve turistike;
- Dukshmëria e aplikantit dhe ueb-faqja profesionale e aplikantit;
- Koha e mbajtjes –nga 01.06- 31.12. 2026 gjatë javës së punës dhe fundjavave (në konsultim me Qytetin e Shkupit);
- Përcaktimi i vendeve për organizimin e shikimit të Shkupit: Në konsultim me Qytetin e Shkupit;
- Sigurimi i draft-projektit të shkurtër me ide;
- Përgatitja e materialit përfaqësues dhe promovues që do të përfshijë agjendën për muajt e vizitave turistike me pozicionin e fillimit, intervalin kohor dhe pozicionin e mbarimit, kohën e fillimit të turit dhe ditët;

- Mbulimi mediatic i projektit, si nga media elektronike ashtu edhe nga media e shkruar (një javë para eventit, reklammat dhe videot të transmetohen në disa stacione televizive dhe radioje, si dhe informacione në gazetatat ditore);
- Të kenë licenca të vlefshme për guidën turistike për qytetin e Shkupit, të lëshuara nga institucion përkatës;
- Mbajtja e regjistrit të veçantë të dokumenteve mbi të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me organizimin e manifestimit, i cili do t'i dorëzohet qytetit pas përfundimit të eventit.

3. KRITERE PËR NDARJEN E KONTRATËS SIPAS THIRRJES PUBLIKE

Si mbajtës i kontratës sipas Thirrjes publike do të zgjidhet ai aplikim që vlerësohet si më i favorshmi nga shuma e pikëve për secilin element në veçanti:

KRITERE	Numri maksimal i pikëve
1. Organizimi i strukturës organizative dhe burimeve	30
1.1 Aplikanti ka strukturën e nevojshme organizative dhe burimet njerëzore – udhërrëfyes turistikë të licencuar për të realizuar aktivitetin.	10
1.2 Aplikanti disponon logjistikë (zyrë dhe pajisje teknike për realizimin e aktivitetit)	10
1.3 Dukshmëria e aplikantit në internet	10
2. Financimi i propozim projektit për realizimin e aktivitetit	30
2.1 Plan financiar i detajuar për mjetet e nevojshme për realizimin e aktivitetit	10
2.2 Aplikanti siguron përqindje të pjesëmarrjes së tij në realizimin e projektit.	10
2.3 Plan financiar real (përshkrimi i shpenzimeve sipas kategorive të pozicioneve korrespondon me çmimet e tregut)	10
3. Cilësia e propozim projektit për realizimin e aktivitetit	40
3.1 Objektiv i përgjithshëm i qartë dhe i përcaktuar në mënyrë adekuate i propozim projektit që do të kontribuojë në realizimin e prioritetëve të dhëna nga Programi i aktiviteteve në fushën e zhvillimit lokal ekonomik të Qytetit të Shkupit.	10
3.2 Zgjidhje cilësore dhe inovative të ofruara në projekt propozim	10
3.3 Sigurimi i përfshirjes së institucioneve dhe organizatave të tjera	10
3.4 Propozim projekti për zbatimin e aktivitetit është i qartë dhe i realizueshëm.	10

Çdo fushë e kriterëve specifike do të vlerësohet me 1 pikë, 5 pikë ose 10 pikë, me kuptimin e mëposhtëm: 1-jo, 5-pjesërisht dhe 10-po.

*Vërejtje:

- Të depozitohen biografite e organizatorëve të aktivitetit;
- Të depozitohet pëlqimi i nënshkruar për aplikim për interes për pjesëmarrje në event, për secilin pjesëmarrës në aktivitet në veçanti;
- Të citohet përvoja e aplikantit në organizimin e aktivitetit (gjatë vlerësimit do të merret parasysh organizimi i aktiviteteve të llojit të ngjashëm, kohëzgjatja dhe profesionalizmi, etj.);
- Në propozim projektin e depozituar duhet të përfshihet program për vizitë në vende turistike, objekte dhe evente;
- në projekt propozimin e depozituar duhet të përfshihet lista e pjesëmarrësve që do të marrin pjesë në aktivitet.



Kryetari i Qytetit të Shkupit
Orce Gjorgjevski